REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA
AUTORITETI KOMBËTAR I KUALIFIKIMEVE
NACIONALNI AUTORITET ZA KVALIFIKACIJE
NATIONAL QUALIFICATION AUTHORITY
Nr.Prot: 01-355 Data: 07.10.2020
Br. Prot: Datum:
Prot. No.: Date:
PRISHTINË/PRIŠTINA/PRISTINA

Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01-355
Datë 07.10.2020

Në mbështetje të neneve 4, dhe 23, të Ligjit nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare dhe Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr. 35/2014 - Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve në mbledhjen e mbajtur me datë 04.09.2020 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Nuk akreditohet** Instituti Profesional "ATC" Sh.P.K me adresë Rr." Bedri Pejani" në Prishtinë, me kualifikimin: **Automekanik,** Niveli III sipas KKK me 31 kredi të AAP

II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m i

I. Instituti Profesional "ATC" Sh.P.K me adresë Rr." Bedri Pejani" në Prishtinë ka parashtruar kërkesë pranë Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK) për akreditim të Institucionit dhe validim të kualifikimit Automekanik, Niveli III, sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (KKK) me 31 kredi të Arsimit dhe Aftësimit Profesional (AAP) të cekura në dispozitivin e këtij vendimi.

AKK ka organizuar vizitën me ekspertë vendor të akreditimit në Institutin Profesional "ATC" Sh.P.K me adresë Rr." Bedri Pejani" në Prishtinë më datë 17.08.2020 me qëllim të vlerësimit për kualifikimin Automekanik, Niveli III, sipak KKK me ekspertët vendor të akreditimit me këtë

përbërje: 1. Z. Luan Gashi, Ekspert i Makinerisë, Kryesues i panelit; 2. Z. Binak Gerguri, Ekspert i Makinerisë, Anëtar i Panelit; 3. Altin Shala, Ekspert për Sigurimin e Cilësisë, Anëtar i Panelit.

Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK) në mbledhjen e mbajtur me datë 04.09.2020 ka shqyrtuar aplikacionin e Institutit Profesional "ATC" dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportin final të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Në lidhje me kualifikimin Automekanik Niveli III, 31 kredi të AAP, raporti i ekspertëve të akreditimit konstaton se Instituti Profesional "ATC" nuk i përmbush kriteret e akreditimit të parapara, prandaj rekomandon mos akreditimin e këtij Kualifikimi.

Në pjesën e dytë të raportit të Akreditimit dhe, ku trajtohet "Qartësimi për kushtet e rekomanduara nga ekipi i ekspertëve", ekspertët vlerësojnë se:

Instituti Profesional ATC nuk ka dëshmuar edhe pas AKK ka dhënë kohen e mjaftueshme bazuar në Udhëzimin Administrativ[1], për të siguruar punëtorinë që e arsyeton profilin Automekanik, i njejti ka refuzuar plotësimin e këtij kriteri thelbësor për akreditimin e këtij programi. Sipas kritereve, profilet profesionale detyrimisht janë të nderlidhura edhe me punen praktike, andaj ne munges të puntoris për automekanik, me qellim që kandidatet të profesionalizohen dhe te marrin shkathtësit e pritura, ekspertët kanë vlerësuar qe ky institucion nuk i përmbush kushtet e parapara për akreditim të këtij programi.

Kualifikimi i Automekut ka një përqindje të madhe e orëve nga modulet praktikë të cilat janë të lidhura direkt me automjete dhe të thuhet se aty mbahet trajnim profesional kur nuk ka mundësi që kandidati ta arrijë pjesën e kompetencave në përvetësimin e shkathtësive profesionale, e të cilat arrihen vetëm kur ai arrin të përfundoj punët i pavarur duke bërë aktivitete për procese të ndryshme nga fillimi deri tek kompletimi funksional sipas moduleve të prezantuara.

Tek memorandumet e bashkëpunimit për realizimin e praktikës të arritura në mes ATC dhe auto serviseve në Kosovë, bie ndesh me shumë aktivitete. Së pari ato auto servise janë në pozita gjeografike që nga objekti i ATC në transportin vajtje ardhje do marrin kohë min 45 min brenda kohës së paraparë edhe për trajnim, kurse plani ditor i orëve nga ATC është i paraqitur me 90 min bllok për një ditë.

Kandidatët, modulet e praktikës profesionale e sidomos në profilin Automekanik nuk kanë asnjë mundësi që për kohën e mbetur 45 min ose edhe 90 min të fitojnë kompetenca profesionale (praktika në industri duhet llogaritur orar të plotë 8 orë në ditë).

Profili është i lidhur ngushtë me punën praktike dhe menaxhmenti ka deklaruar se ka lidhur disa memorandume bashkëpunimi me kompani private që merren me shërbime në fushën e

[1] Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr. 35/2014 - Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë.

Automekanikes. Në ato marrëveshje ka shumë pika të paqarta ku nuk specifikohen qartë obligimet e palëve dhe kohëzgjatja me numrin e orëve për secilin modul në industri (auto servise), mënyrat e vlerësimit për orët e kaluara në industry, ndarjen e detyrave dhe projekteve nga instruktori i ATC si dhe obligimet tjera reciproke.

Tek programi i kursit ka një diskrepancë/mospërputhje sa i përket rezultateve mesimore (tash e tutje RM), ku ka module me nga 20 RM që sipas numrit të kredive nuk ka mundësi logjike, ndërsa tek përmbajtja është numër tjetër i RM kurse tek përshkrimi është numër tjetër i paraqitur.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pika 1, 2, 3 dhe 4 e Udhëzimit Administrativ Nr. 35/2014, Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorzohet KD të AKK, në afat prej 15 ditësh pas pranimit të vendimit.

Vendimi u dërgohet:

- Instituti Profesional "ATC";
- Divizioni për Arsim Privat Parauniversitar – MASH;
- Arkivit të AKK.

Prof. Dr. Agron Bajraktari
Nënkryetar i KD të AKK